



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 2664 prot.,

Vlorë, më 20.02.2024

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë _____. 2024

**PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DREJTUAR
MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT PËR “PROGRAMIN
E PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA
DHE TË PAFAVORIZUARA”**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë,

V E N D O S I

- I. Të miratojë deklaratën për bashkëfinancim drejtuar Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për “Programin e përmirësimin të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” në dy projektet :
 - 1.Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese.
 - 2.Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje, që janë në proces legalizimi në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme.
- II. Të miratojë deklaratën për financimin e :
 - 1.Projekeve të përmirësimin të kushteve të 6 banesave ekzistuese për vitin 2024 në masën 50% të kostos totale të projektit nga buxheti i Bashkisë Vlorë =2 824 974,5 lekë dhe kërkesën për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit në masën 50% të kostos së projektit = 2 824 974,5 lekë me tvsh.
 2. Projektit për rikonstruksionin e rrugës në fshatin Drithas të Njësisë Administrative Shushicë në masën 50% të kostos totale të projektit nga Bashkia Vlorë = 8 804 997 lekë dhe kërkesën për bashkëfinancimin e këtij projekti në masën 50% nga buxheti i shtetit= 8 804 997 lekë.Në total për të dy projektet Bashkia Vlorë deklaron se do të financojë vlerën =11 629 971,5 lekë dhe do të kërkojë për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit vlerën =11 629 971, 5 lekë.

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si edhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

Drejtori i DI&IP: *Z.Selmani*

Drejtori i Drejtorisë Juridike: *D.Depiri*

KRYETARI

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 2664 prot.,

Vlorë, më 20.02.2024

Lënda: Deklaratë për bashkëfinansim për projektin “Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”.

DREJTORISË SË STREHIMIT

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Tiranë

Mbështetur në shkresën Nr. 741prot., datë 12.01.2024 “Mbi fondet për programin e strehimit 2024” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë aplikon për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, në programin “Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” në dy projekte si vijon:

1. Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese për familje. Në këtë rast janë përfshirë në projekt 6 familje nga shtresat në nevojë që banojnë në lagje ekzistuese të qytetit të Vlorës, konkretisht në rajonet nr.1, nr.3 dhe në Njësinë Administrative Qendër.
2. Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje, që janë në proces legalizimi në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme. Në këtë rast është parashikuar rikonstruksioni i rrugës në fshatin Drithas të Njësisë Administrative Shushicë, ku gjenden banesat për rreth 380 familje dhe aktualisht jetojnë më shumë se 250 familje.

Në buxhetin e vitit 2024 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.100, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2024” në zërin e investimeve është parashikuar shuma prej 6.000.000 lekë për projektet e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara. Shuma totale e preventivit për rikonstruksionin e 6 banesave është 5 649 949 lekë. Nisur nga tabela nr.2 për kufijtë e financimit në varësi të nivelit të të ardhurave për frymë sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2022“, Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 50% të koston totale të projektit. Pra Bashkia Vlorë për projektin e përmirësimit të kushteve fizike për 6 banesa do të financojë 50% të vlerës = 2 824 974, 5 lekë

Do të kërkojë bashkëfinancim nga buxheti i shtetit vlerën = 2 824 974,5 lekë.

Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Drithas është parashikuar në buxhetin vjetor 2024 në shumën prej 17 609 994 lekë sipas projekt preventiv të hartuar. Bashkia Vlorë do të financojë 50% të vlerës = 8 804 997 lekë, duke kërkuar për bashkëfinancim shumën = 8 804 997 lekë.

Në total për të dy projektet Bashkia Vlorë deklaron se do të financojë vlerën = 11 629 971, 5lekë

Kërkon nga buxheti i shtetit si bashkëfinancim vlerën = 11 629 971, 5 lekë.

Deklarata për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtorisë së Strehimit, me vlerën përkatëse dhe vlera që do të financojë Bashkia Vlorë për zbatimin e këtyre projekteve, do të paraqitet për të miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë në mbledhjen e radhës. Mbas miratimit do të dërgojmë kopje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë pranë ministrisë suaj.

Konceptoi: *D. Mustafai*



Miratoi: *Z. Selmani*



KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Për projekt-vendimin

**PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DREJTUAR
MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT PËR “PROGRAMIN
E PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA
DHE TË PAFAVORIZUARA”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr.923prot., datë 19.01.2024 “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2024”, ka njoftuar të gjitha njësitë vendore mbi fondet e planifikuara për programet e strehimit për vitin 2024, duke i fuar të aplikojnë për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar. Njoftimit për aplikim i bashkëlidhen “Termet e referencës për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2024-2025”, që parashikojnë;

1. Llojet e projekteve që do të financohen nga buxheti i shtetit dhe kufinj të financimit për familje,
2. Kushtet që duhet të plotësojë bashkia për t’u kualifikuar, formatin e aplikimit, dokumentacionin që do të hartohet për projektin, si dhe dokumentacionin që do të dorëzohet pranë ME, K&I për t’ju paraqitur Komisionit të Vlerësimit të Projekteve për shqyrtim dhe vlerësim (Dosja e aplikimit).

Nisur nga kërkesat e regjistruara pranë Bashkisë Vlorë nga familje/individë, të cilët disponojnë banesa të amortizuara në një ose më shumë pjesë të tyre, janë të papërshtatshme për banim të mëtejshëm, apo rrezikojnë jetën e banorëve nga mungesa e investimeve dhe e riparimeve ndër vite, për shkak të problematikave ekonomike dhe sociale të vazhdueshme, dhe nga kërkesat e vazhdueshme të banorëve të fshatit Drithas të Njesisë Administrative Shushicë për rikonstruksionin e rrugës së këtij fshati që e lidh me qendrën e njësië dhe më gjerë, nga ana jonë është zgjedhur aplikimi në programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara, në dy projekte:

- 1.Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese.
- 2.Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje, që janë në proces legalizimi në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme.

Grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.27, datë 29.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ” Mbi ngritjen e grupeve të punës për hartimin e project-preventivave në zbatim të projektit “Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” si edhe specialistët e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit kanë hartuar projekt-preventivat;

1. Për përmirësimin e kushteve të banesave për 6 familje/individë që jetojnë në 6 banesa të ndryshme në shumën totale prej 5 649 949 lekë.
2. Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Drithas të Njësisë Administrative Shushicë simbas projekt preventivit të hartuar është parashikuar në vlerën prej 17 609 994 lekë

Ministria në termat e referencës ka përcaktuar edhe përqindjen e bashkëfinancimit që i takon të financojë çdo bashki nga buxheti i saj sipas pikës 7 të Udhëzimit të Ministrisë nr.31, datë 18.11.2019, sipas nivelit të të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2022 të përcaktuar me tabelë.

Nisur nga tabela nr.2 për kufijtë e financimit sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2022“ , Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 50% të kostos totale të projektit.

1. Pra, Bashkia Vlorë do të financojë 50% të vlerës së projektit për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese = 2 824 974,5 lekë
2. Dhe 50% të vlerës së projektit të rikonstruksionit të rrugës së fshatit Drithas = 8 804 997 lekë.

Në total për të dy projektet Bashkia Vlorë deklaron se do të financojë vlerën = 11 629 971, 5lekë

Kërkon nga buxheti i shtetit për bashkëfinancim vlerën = 11 629 971, 5 lekë.

Deklarata për financim nga buxheti i Bashkisë Vlorë me vlerat përkatëse dhe kërkesa për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit me vlerat përkatëse, duhet të miratohen në parim nga Këshilli i Bashkisë Vlorë dhe të përcillen pranë ministrisë zbatuese të projekteve si pjesë e dosjes së aplikimit.

Sa më lart, është hartuar ky projekt-vendim i paraqitur për miratim të këtij Këshilli.

KRYETARI
Ermal Dredha



Konceptoi: D.Mustafai

Miratoi: Z.Selmani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 2004/2 prot.,

Vlorë, më 20.02.2024

MIRATOHET
KRYETAR

Ermal Dredha

VENDIM

Nr. 1, datë 12.02.2024

Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Për programin përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, shkresën MF&E Nr.923prot., datë 19.01.2024 “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2024”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë i mbledhur në datën 12.02.2024, pasi shqyrtoi projekt-preventivat, kostot për punimet e parashikuara sipas termave të referencës dhe kufij të e lejuar të financimit për çdo banesë në projektin e riparimit të kushteve fizike të banesave ekzistuese, koston për rikonstruksionin e rrugës së fshatit Drithas e marrë nga projekt-preventivi i hartuar, si edhe vlerat e parashikuara në projekt-buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024 në zërin e investimeve,

KONSTATOI SE:

Në buxhetin e vitit 2024 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.100, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2024” në zërin e investimeve është parashikuar shuma prej 6.000.000 lekë për projektet e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara. Shuma totale e preventivit për rikonstruksionin e 6 banesave është 5 649 949 lekë.

Nisur nga tabela nr.2 për kufijtë e financimit në varësi të nivelit të të ardhurave për frymë sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2022“, e përcaktuar në Termat e Referencës nga ministria që mbulon strehimin, Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 50% të kostos totale të projektit.

2. Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Drithas është parashikuar në buxhetin vjetor 2024 në shumën prej 17 609 994 lekë sipas projekt preventivit të hartuar. Bashkia Vlorë duhet të financojë 50% të vlerës së këtij projekti.

Sa më lart komisioni,

VE ND O S I

1. Bashkia Vlorë për projektin e përmirësimit të kushteve fizike për 6 banesa të financojë 50% të vlerës = 2 824 974,5 lekë. Të kërkojë bashkëfinancim nga buxheti i shtetit shumën = 2 824 974,5 lekë.
2. Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Drithas është parashikuar në buxhetin vjetor 2024 në shumën prej 17 609 994 lekë sipas projekt preventivit të hartuar. Bashkia Vlorë të financojë 50% të vlerës = 8 804 997 lekë. Të kërkojë për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit vlerën = 8 804 997 lekë.
3. Në total për të dy projektet Bashkia Vlorë deklaron të mbulojë vlerën prej 11 629 971,5 lekë
4. Të kërkojë nga buxheti i shtetit shumën prej 11 629 971,5 lekë.
5. Deklaratën për vlerën e financimit që merr përsipër të mbulojë Bashkia Vlorë dhe vlerën për bashkëfinancim që kërkohet nga buxheti i shtetit do të përgatitet project-vendimi që do të përcillet për të miratuar në Këshillin e Bashkisë. Vendimi i miratuar do të përcillet ministrisë si kusht i vendosur për kualifikim, pjesë e dokumentacionit që përmban dosja e aplikimit.

KOMISIONI

1. Irena Toshkallari
2. Zambak Selmani
3. Dorian Demiri
4. Ali Çakërrri
5. Orest Ruçaj
6. Manuela Prifti
7. Donald Leskaj

8. Brisilda Çobaj
9. Kanan Shakaj
10. Genard Fegaj
11. Selim Haskoçela
12. Birçe Aliraj
13. Drita Mustafai